



Tranjeri i kombetares De Biasi ka shpallur sonte ne darke listen zyrtare te 23 futbollisteve qe do te bejne pjese e kampionatit europian France 2016. Nga 27 lojtaret e grumbulluar per pergatitjet para-europianit, 4 futbolliste nuk do jene me pjese e ketyre pregatitjeve te cilet jane: Rrahmani, Xhimshiti, Shala dhe Rashica.

Kete sezon Berat Xhimshiti nuk eshte aktivizuar rregullisht me skuadren e tij dhe vetem ne javet e fundit ka gjetur hapësira me Atalanten.

Rrahmani ka zhvilluar nje kampionat te mire me ekipin e tij RNK Split, por konkurenca ne qendren e mbrojtjes ka bere qe mos te jete ne listen perfundimtare.

Gjate elimatoreve te kampionatit europian, mesfushori me tipare sulmuese, Herolind Shala eshte thirrur vazhdimisht nga tranjeri De Biasi, por as ai nuk eshte perfshire ne listen perfundimtare.

Lojtari me premtues i kombetares shqiptare dhe me nje te ardhme te sigurve, Milot Rashica nuk ka arritur te bind plotesisht tranjerin dhe kesisoj as ai nuk do te jete pjese e Shqiperise ne Euro 2016.

Ja dhe lista e plote zyrtare e lojtareve qe do te jene pjese e finaleve te kampionatit europian:

1. Etrit Berisha
2. Orges Shehi
3. Alban Hoxha
4. Elseid Hysaj
5. Lorik Cana
6. Arlind Ajeti
7. Mërgim Mavraj
8. Naser Aliji
9. Armir Lenjani

De Biasi publikon listen zyrtare per ne France 2016

nga Administrator
E martë, 31 Maj 2016 22:29

10. Ansi Agolli
11. Frederik Veseli
12. Andi Lila
13. Mlgjen Basha
14. Ledian Memushaj
15. Burim Kukeli
16. Taulant Xhaka
17. Ergys Kaçe
18. Armir Abrashi
19. Odise Roshi
20. Bekim Bala
21. Shkëlzen Gashi
22. Sokol Cikalleshi
23. Armando Sadiku